

MIRATOI  
KRYETARI I BASHKISE  
ERISELDA SEFA



## RELACIONI PMNZSH-së

**OBJEKTI:** NDERTIMI I QENDRES SHENDETESORE  
FIERSHEGAN, NJESIA ADMINISTRATIVE FIERSHEGAN  
BASHKIA LUSHNJE



## **Pershkrimi i impiantit, normat e projektimit, dhe kalkulimet.**

### **Hyrje**

Hartimi i projektit te impianti te mbrojtjes nga zjarri MKZ eshte mbeshtetur, dispozitat legislative shqiptare, sipas Udhëzimit Nr. 81, datë 6.3.2020. "Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Udhëzimi Nr. 424, Datë 24.07.2015 "Për Miratimin e Rregullave Teknike për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi në ndërtimet e destinuara për banim", Udhëzimi Nr 425, datë 24.07.2015 "Për Pranimin, Administrimin e dokumentacionit Teknik dhe Grafik të Projektit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe per Shpëtim dhe lëshimin e Akteve Teknike", si dhe mbi normat europian te cilat vijne ne mbeshtetje te ketij vendimi. Ky projekt ka per qellim mbrojtjen e jeteve njerzore dhe te mirave materiale nga rrezja e zjarrit. Nepermjet ketij projekti sigurojme dy forma te mbrojtjes nga zjarri per situatat emergjente, si dhe per shuarjen e zjarrit.

### **1- Siguria nga zjarri në objektet.**

Menaxhimi i objektit, duhet të njohë se standardet e sigurisë duhet të reflektojnë një kulturë të sigurisë në terrenet e mbyllura.

Përderisa çdo objekt është i ndryshëm dhe siguria nga zjarri ndahet gjerësisht ne tri zona:

### **2- Evakuimi**

Evakuimi i nje numri te madh njerezish nga objekti duhet te realizohet shpejt dhe me lehtësi.

Vendi duhet të jetë i projektuar për të siguruar që çdo zjarr mund të përfshihet në një zonë të vogël, duke zvogëluar numrin e personave në rrezik.

### **3- Parandalimin e zjarrit**

Çdo aspekt i projektimit dhe ndërtimit duhet të zbatohet me parandalimin e zjarrit në Mendje.



#### **4- Përballja me një zjarr**

Sigurohuni që ju te keni aparate te duhura për te fikur zjarrin me disa lloje të ndryshme te paisjeve te fikjes se zjarrit në të gjithë objektin. Ajo gjithashtu do të jetë një ide e shkëlqyer per te minimizuar zjarret.

#### **5- Pershkrimi i impjantit MKZ**

Impjanti i mbrojtjes nga zjarri i objektit do te realizohet ne baze te standarteve dhe normave lokale si dhe ato te vendeve te Komunitetit European. Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit respekton te gjitha kerkesat e detyrueshme shteterore qe kane te bejne me normat/standartet qe jane ne fuqi aktualisht ne Shqiperi. Gjate procesit te aplikimit te sistemit duhet qe te kontaktohet me autoritetet vendore te MKZSH per te siguruar nje testim dhe aprovim te ketij instalimi.

Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe destinacionin e tij, do te perdoren substanca shuarese si me poshte :

Shuares portabel me pluhur ne ambjentet e brendshme.

Faktoret percaktues qe jane marre ne konsiderate gjate projektimit jane natyra dhe permasa e zjarrit, madhesia e zones qe do te mbrohet, mundesia e perhapjes me shpejtesia e zjarrit, kerkesat dhe normat sipas UNI 10779 si dhe ato qe jane ne fuqi ne Shqiperi.

#### **6- Shuaresit portabel te zjarrit**

Shuares zjarri portatel, me pluhur 6kg dhe 9kg, te klases 43A-233BC si edhe shuarres zjarri me anidrid karnonik te klases B-8C (per ambjentet teknike) do te vendosen ne pozicionet e percaktuara ne projekt. Numri i shuareve portabel dhe pozicioni i tyre ne godine jane percaktuar ne menyre te tille qe te mund te garantohet lehtesia e arritjes tek hidranti.

#### **7- Ndarja e zonave dhe klasifikimi i zjarreve.**

Per te perdorur agjendet shuares gjate momenti kur bie zjarr, me pare duhet te behet nje analize e materialve te djegshem qe ndodhet ne ate zone, dhe mbi bazen e kesaj analize behet dhe klasifikimi i zjarreve dhe me pas zgjidhe agjendi dhe pajisja shuares qe do



perdoret ne ate zone. Nga sa permendem me siper, si dhe duke u mbeshtetur mbi normat dhe standartet

bashkohore, zjarret i ndajme ne 6 klasa te cilat shprehen ne tabelen e meposhtme:

TABELA E KALSIFIKIMIT TE ZJARREVE			
1		Klasa A	Zjarret qe kane burimin nga objekte te ngurta sic jane, druret, letra, plastike dhe tekstile
2		Klasa B	Zjarret qe kane burimin nga materialeve telengshem, sikurse benzene , benzole , nafte, alkol , vajra etj.
3		Klasa C	Zjarret qe e kane burimin nga materialeve te gazte sikurse metan , propan , butan GPL etj.
4		Klasa D	Zjarret qe e kane burimin nga prej materialeve metalike sikurse alumin, magnesium, sodium, etj.
5		Klasa E	Zjarret qe e kane burimin nga pajisjete nen tension.
6		Klasa F	Zjarret qe e kane burimin nga gatimi i ushqimeve ne guzhina

### ***Pjisjet dhe agjendet shuarse***

Ne baze te karakteristikave dhe te natyres se ambienteve, si dhe aktiviteteve qe kryhen ne kete godine, ateher ne do te perdorim keto pajisje dhe agjend shuarse respektivisht ambientit:

*Agjendet shuarse.*



Bombula-Murale me pluhur

### **5- Rrjeti i sistemit te dedektimit te zjarrit**


Sistemi Dedektim zjarri ose mbrojtjes kundër zjarrit është një sistem që paralajmëron personelin për praninë e zjarrit ose të tymit në objekt. Kjo realizohet nëpërmjet sensoreve të tymit, zjarrit apo edhe përbërësve kimike të rrezikshëm që shoqërojnë zjarrin qoftë edhe në fazat e para të tij.

Sirenat e brendshme do te jene analoge te adresueshme ndersa te jashtmet duhet te jene konvencional te cialt do te lidhen ne sistemin analog te Loop me nje modul qe konverton linjen analoge ne konvencionale.



Ky sistem duhet te perdor kabell te kuq me seksion  $2 \times 1 \text{ mm}^2 + \text{SH}$  dhe duhet te perdoren tuba rigid ne raste instalimesh te jashtme ose tuba fleksibel te rende per ato instalime qe jane te brendshme ne mure.

Në figurën e mëposhtme tregohet një sensor tymi i cili paralajmeron rrezikun e zjarrit për të gjithë godinën duke vënë në alarm nëpërmjet kontakteve elektrike të gjithë sistemin antizjarr.



Sensor tymi dhe zjarri

Sensoret qe do te perdoren jane zgjedhur si pershtatja me e mire me arkitekturen dhe ambjentin ku ato do te perdoren njekohesisht në varësi edhe te sipërfaqes.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit

Ing. Ariola Beqo

Hartoi: Ing. Arben Muca

Pergjegjes: Ark. Alban Manoku